REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 48/20
Date/Datum 27.01.20
PRISHTINË / PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

| Visar BIBAJ / Ekspert Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Data e dorëzimit të raportit | Nr. lëndës: |
|---|---|---|---|
| | 22.01.2020 | 27.01.2020 | **48/2020** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 20.01.2020, ne cilësi të OE "Telekomi i Kosovës "sha - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: **20/2020**, kundër njoftimit për kontrate, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-19-9669-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti "Hasan Prishtina".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **50 000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

**AK ka shkelur nenin 9.4 te LPP-se**

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: "autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t 'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për me tepër edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevoje te procedoj ndonjë procedurë të prokurimit përderisa një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-së: 36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoja për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik ? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4,

kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t 'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".

Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoje për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.
LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre ( ne mes vete) meqë kjo është qeshje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.
Mirëpo është mese e qartë se këto raste kanë të bëjë me përjashtimet nga zbatimi i Legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tije ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim " në shtëpi).

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së
KRPP, nuk do te publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontrate, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore ne rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me larte apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit për prokurim publik.

LINKU: https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=NewsPub&LID=l&PCID=-l&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=313

Propozimi i telekomit te Kosovës
Të anulohet Njoftimi për kontratë nga UNIVERSITETII PRISHTINËS dhe te fillohet një procedurë e re në përputhje me interpretimin e KRPP_së dhe në kërkesat e nenit 9.4 të LPP-së.
Dmth, bazuar në interpretimin e KRPP_së lidhur me nenin 9.4 të LPP-së, si dhe vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së për pretendimin e njëjtë ankimor të shqyrtuar në të kaluarën (vendimi nr. 409/19 I datës 04.09.2019 kundër Njoftimit për Kontratë nga Kuvendi i Kosovës, vendimi nr. 338/19 i datës 16.08.2019 kundër Njoftimit për Kontratë nga Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, etj.), UNIVERSITETI I PRISHTINËS nuk ka nevojë të përdor procedurë të prokurimit, pasi që shërbimet në fjalë ofrohen nga një institucion publik që përdor fonde publike.

Mënyra proceduese e anulimit është: UNIVERSITETI I PRISHTINËS duhet te kërkoj nga KRPP ose autorizim që të bëjë anulimin e Njoftimit për kontratë

**KRITERET PËR VLERËSIM**

**Kërkesat e përshtatshmërisë:**

**Kërkesa 1.** Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi rshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. ( Obligative për të gjithë OE)

**Kërkesa 2.** Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se OE i ka kryer Obligimet tatimore ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Vetëm për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës

**Kërkesa 3.** Vërtetim nga Gjykata Ekonomike- që nuk është në procedurë gjygjësore ose i dënuar më parë për vepër penale, vërtetimi jo më i vjetër se tre muaj përpara dorëzimit të tenderit. Vetëm për tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës

**DESHMIA DOKUMENTARE**

**Evidenca 1.** Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit (origjinal)

**Evidenca 2.** Vërtetim nga ATK-ja se nuk ka borxhe ndaj shtetit të Kosovës ose marrëveshjen me ATK, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit

**Evidenca 3.** Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike- (origjinal ose kopje e notarizuar).Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshme risë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit Universiteti i Prishtinës ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të vendimit të AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të Universiteti i Prishtinës-se për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet , do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe Universiteti i Prishtinës do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

**PERSHTATSHMERIA PROFESIONALE**

**Kërkesa 1.** Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik-Çertifikata Regjistrimit të Biznesit

**Kërkesa 2.** Certifikata e TVSH

**DESHMIA DOKUMENTARE**

**Evidenca 1.** Çertifikatë e regjistrimit të biznesit me llojet e veprimtarive të regjistruara- (kopje).

**Evidenca 2.** Certifikata e TVSH kopje

**KERKESATE E KAPACITETIT EKONOMIK DHE FINANCIAR**

**Kërkesa 1.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, ose grupit të OE-ve gjatë 3 viteve të shkuara që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 75,000.00€. Në rast se OE janë në konzercium lideri duhet ta përmbush 60% e vlerës së lartëcekur

**DESHMIA DOKUMENTARE**

**Evidenca 1.** Raport i qarkullimit Bankar Origjinal

**KERKESATE E KAPACITETIT TEKNIK DHE PROFESIONAL**

**Kërkesa 1.** OE- duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjashme në tri vitet shkuara që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 100,000.00€

**Kërkesa 2.** Lista e stafit qe do te jen pjesë e këtij projekti. ;

1. Një Inxhinier i Diplomuar (Master) nga Elektroteknika
2. Një Inxhinier i Diplomuar (Master) nga fusha e IT-së
3. Minimumi 5 puntor per kryerjen e shërbimeve.

**Kërkesa 3.** Deklarata mbi përshtatshmërinë e specifikacioneve teknike.

**Kërkesa 4 .** Menaxheri i projekti duhet te jet Inxhinier i diplomuar (Master)i Shkencave Kompjuterikë

**Kërkesa 5.** Dëshmi për shërbimet e kërkuara

**DESHMIA DOKUMENTARE**

**Evidenca 1.** Një listë te furnizimeve- shërbimeve të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave ose referenca pozitive ose raporti i pranimit teknik) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i liferimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës (transaksioni bankar).Për situatën referuar evidences 1 te pikës 9.2 OE duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në aneksin 8 te DT dhe te bashkëngjisë certifikatat ose referencat pozitivë ose raporti i pranimit teknik përkatës qe evidenton liferimin

**Evidenca 2.** OE ne listën e bashkangjitur duhet ti ket këta punëtor 1. Një ING Elektroteknikes (Master) Diploma e ING e noterizuar,CV-ja, Kontrata e punës, Referenc nga OE per punët e kryera dhe provoja e punës natyrës se ngjashme. 2. Një ING i IT-së(Master) Diploma e ING e noterizuar,CV-ja, Kontrata e punës, Referenc nga OE per punët e kryera dhe provoja e punës natyrës se ngjashme. 3.Te dëshmohen 3.Kontrata e puntoreve me afat Valid min 6 muaj

**Evidenca 3.** Deklarata mbi përshtatshmërinë e specifikacioneve teknike, Bashkangjitur specifikimi teknik i detyrueshem Origjinal e nënshkruar dhe vulosur

**Evidenca 4.** Vendim për Menaxher te projektit bashkangjitur diploma e noterizuar provoja e punës 2 vite
**Evidenca 5.** Një deklarata dëshmi se te gjitha shërbimet kryhen sipas kërkesës se Njësisë kërkuese për periudhën 36 muaj,si dhe maximumi i intervenimit ne rast te defekteve me qen 60 min ne vendin e ngjarjes

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

**Ska**

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi me nr.338/19, i datës 16.08.2019 dhe

Vendimi nr. 409/19, te datës 04.09.2019, te cilët kan aprovuar ankesën e OE edhe tani ankues "Telekomi i Kosovës', me arsyetimin se ekziston marrëveshja e lidhur me TK dhe MAP.

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Neni 35, i LPP-se ne fuqi, si dhe skadimi i marrëveshjes se TK dhe MAP, me datën 31.03.2012

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Etiani Shpk & Lurn shpk - ISTOG

**Sqarim hyrës:** **Sqarim Hyrës:** Autoriteti Kontraktues - "Universitetit "Hasan Prishtina", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë.

- Kundër të njëjtit njoftimi parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, më datën 03.01.2020, ka paraqitur kërkese për rishqyrtim pran AK-se, me pretendimet e njëjta ankimore si ne ankesën e dorëzuar ne OSHP.

**Përgjigjeje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) :** Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër procedurës së aplikuar nga autoriteti kontraktues, rrjedhimisht kërkohet anulimi i kësaj procedure me qellim që AK–Universiteti "Hasan Prishtina", për këto shërbime të përjashtohet nga legjislacioni për prokurim publik, në kuptimin që të aplikohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit me arsyetimin se një gjë të tillë e parasheh neni 9, paragrafi 4, i LPP-s, si dhe një interpretim i dhëne nga KRPP.

- Sa i përket nenin 9, si tërësi, përfshirë edhe paragrafin 4, vlerësimi ynë është se dispozitat e të njëjtit nenë, sqarojnë vlerësimin dhe planifikimin paraprak të prokurimit sipas nevojave që ka një Autoritet Kontraktues i caktuar, por assesi përjashtimin nga procedura e prokurimit publik apo të drejtën për aplikim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit. Për të njëjtën procedurë dispozitat e nenit 35, të LPP-s, janë të qarta dhe sqarohet kur një Autoritet Kontraktues mund të përdor procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit.

Parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, është thirrur edhe ne praktikat e me paraprake te vendim marrjes në OSHP, përkatësisht i është referuar vendimeve me nr. 338/19, te datës 16.08.2019 dhe nr. 409/19, te datës 04.09.2019. Arsyetimet e vendimeve te larte përshkruara kryesisht thirren ne marrëveshjen lidhur nga "Telekomi i Kosovës", tani ne cilësi te OE-s, dhe "Ministres se Administratës Publike" (MAP), marrëveshje e cila është e vlefshme deri me datën 31.03.2019, ku janë te përfshira edhe shërbimet, objekt i kësaj procedure te prokurimit.

Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua me larte vlerësimi ynë është qe AK/ Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ka iniciuar procedure te prokurimit ne mbështetje të dispozitave te LPP-se, (AK ka iniciuar kontrate kornize 3 vjeçare). Përkatësisht meqë marrëveshja e lidhur nga "Telekomi i Kosovës", dhe "Ministres se Administratës Publike" (MAP), skadon me datën 31.03.2020, ti lejohet AK/ Universitetit "Hasan Prishtina", te procedoj tutje me aktivitetin e prokurimit sipas dispozitave te LPP-se.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, "Telekomi i Kosovës", të refuzohet si e pa bazuar, dhe AK-së – Universitetit te Prishtinës "Hasan Prishtina", ti lejohet te procedoj tutje me procedurat e prokurimit.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "Telekomi i Kosovës" sha.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Uni. Prishtine "Hasan Prishtina".